

**STATUT I SHOQERISE
“FLYMEDIA” Sh.P.K.**

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 19 janar 2021, personi i meposhtem:

Z. Erlind Koçi, shtetas Shqiptar, lindur me 29.01.1988 ne Gramsh, e banues ne Tirane, mbajtës i leternjoftimit nr . 032196040 dhe numrit personal **I80129074P**.

ne përputhje me LigjinNr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

**Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 19 janar 2021 unë, themeluesi i mësipërm, vendosa te krijoj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar **“FLYMEDIA” SH.P.K.**

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Sherbime marketingu dhe tregtimi nepermjet telefonit (call center)

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*.

**Neni 4
Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Shqipëri, Tiranë, Rruga Ali Demi, Pall "Edil AL-IT", shkalla 1, Kati 3, ap 25.**

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 Lek (*njeqind lek*).

Kapitali themeltar ne para eshte nenshkuar nga Ortaket i vetem i Shoqerise si me poshte:

Erlind Koçi, shtetas Shqiptar, lindur me 29.01.1988 ne Gramsh, e banues ne Tirane, mbajtës i leternjoftimit nr . 032196040 dhe numrit personal **I80129074P**, zoterues i 1 kuote me vlerë 100 Leke që perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise;

5.2 Pergjegjesia e ortakeve per detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

5.3 I gjithe kapitali themeltar eshte nenshkuar dhe zoterohet teresisht nga Ortaket e Shoqerise.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj. Çdo disponim ne favor te nje pale te trete nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet te gjallëve duhet te behet ne forme notariale dhe te regjistrohet. Ne rastet e transferimit te pjesëve te kapitalit me kundërshpërblim, ortaket e tjerë kane te drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8 **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë pér çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpérndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Per sa kohe qe kapitali themeltar i Shoqerise zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do te ushtroje kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 9 **Mënyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të

përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruvesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi: **Z. Erlind Koçi**, shtetas shqiptar, me 29.01.1988 ne Gramsh, e banues ne Tirane, mbajtës i mbajtës i leternjoftimit nr. 032196040 dhe numrit personal **I80129074P**, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Kreu IV
Viti finansiar-ekspertet

Neni 14
Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 15
Ekspertet

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit reportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja – Rioranizimi i Shoqërisë

Neni 16
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 17
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 18
Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 19
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tretëve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Ky akt u hartua ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

**ORTAKU THEMELUES
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
FLYMEDIA Sh.P.K.**


Erlind Koçi